



Prishtinë: 20.12.2011

Kodi i ZRRE-së: V_390_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_650_09_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, Nenit 17 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_650_09_11;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 31.10.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Besim Beka (shifra e konsumatorit në KEK: DMI – 17937) nga fshti Kçiq i Madh, Mitrovicë, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 31.10.2011 ka apeluar vendimin e DMK nr. ZRRE/DMK_V_650_09_11 të datës 19.09.2011 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 31.10.2008, punëtorët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse, ku kanë theksuar se njehsori elektrik i ka dy dalje njëra shkon në njehsor e tjetra në ndërpres (1,0,2), në rast nevojë konsumatori e anashkalon njehsorin elektrik, do të thotë nuk bënë matjen e energjisë elektrike të shpenzuar.
Provë: Kërkesa e konsumatorit në KEK, nr. 170746 e datës 31.10.2008
- Me datë 05.11.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DMI08HP01714 në vlerë prej 2,038.26 €.
Provë: Fatura DMI08HP01714 e datës 05.11.2008
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 12.01.2011 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 12.01.2011
- Me datë 17.01.2011 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së e datë 17.01.2011



- Me datë 19.09.2011 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka lëshuar vendimin duke refuzuar ankesën e konsumatorit si të pa bazë.

Provë: Vendimi i DMK-së i datës 19.09.2011

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_650_09_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin si në arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK_V_650_09_11** të mbetet në fuqi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, anëtar